

Për myslimanët, Bajrami i Ramazanit është kohë pajtimi, faljeje dhe respekti, para së gjithash ndaj të moshuarve duke u puthur duart. Më të gëzuarit në këtë festë janë fëmijët, të cilët përveç veshjeve të reja marrin edhe dhurata

SHP KUMANOVË

NË IFTARIN NË LIKOVË



Me ftesë të kryetarit të Komunës së Likovës, Ekrem Arifi, me rastin e festës së Ramazan Bajramit, Udhëheqësia e SHP Kumanovë, së bashku me anëtarët e Bordit Ekzekutiv dhe Komisionet kanë vizituar Likovën më datë 11.04.2024. Sipas traditës, të ftuarit u pritën me dashamirësi nga mikpritësit në restorantin Panorama, ku u gostitën me bakllava tradicionale të bëra vetë. Kryetari i SHP Kumanovë, Risto Boshkov,

gjatë takimit të zhvilluar i uroi nikoqirëve festën, në emër të tij dhe në emër të shoqatës, me urimin për shëndet e mbarësi dhe në shenjë mirënjohjeje, i akordoi Mirënjohje Abedin ef Imerit nga Bashkësia Fetare Islame në Kumanovë dhe kryetarit të Komunës së Likovës, Erkan Arifi, të cilit për shkak të mungesës së arsyeshme do t'i jepet nga kryetari i Kuvendit të SHP të Kumanovës, Nazim Emiri.

Nga përfaqësuesi i Bashkësisë Fetare Islame mësuam se kjo festë e madhe festohet për 3 ditë dhe fillon pas përfundimit të muajit të Ramazanit, kur agjërimi bëhet pa ngrënë dhe pa pirë nga lindja e diellit deri në perëndim të diellit. Festa fillon me lutje në xhami. Më pas vizitohen varret e të ndjerëve. Për myslimanët, Bajrami i Ramazanit është kohë pajtimi, faljeje dhe respekti, para së gjithash ndaj të moshuarve duke u puthur duart.

Më të gëzuarit në këtë festë janë fëmijët, të cilët përveç veshjeve të reja marrin edhe dhurata. Humaniteti është një nga karakteristikat kryesore të kremtimit të kësaj feste të madhe myslimane. Me rastin e festës vizitohen të varfrit dhe u jepën dhurata që edhe ata ta festojnë festën me dinjitet dhe shoqatat ndajnë edhe pako humanitare. Pas takimit u bisedua për Likovën dhe digën e Glazhnjës. (Rosica Mitiq)

SHP ÇAIR

Shoqërimi i përbashkët dhe shënimi i Iftarit

Aktivi i pensionisteve pranë SHP Çair, më 2 prill të këtij viti, në klubin e pensionistëve në Fushë Topanë, me rastin e muajit të shenjtë të Ramazanit, organizoi pas orës 19:00 një darkë iftari të përbashkët, ku morën pjesë disa gra pensioniste, anëtare të SHP Çair nga komuniteti maqedonas, shqiptar dhe të tjerë. Pensionistet nga Aktivi i komunitetit maqedonas u organizuan dhe me mjetet e tyre përgatitën një darkë iftari për besimtarët myslimane. Për atë rast, ata përgatitën specialitete të freskëta dhe të shijshme të bëra vetë, biskota, byrekë, kifletë ëmbla



dhe të kripura, mini pica, simite etj. Në darkë u diskutua për ndërmarrjen e më shumë aktiviteteve, të cilat synojnë përmbushjen e programit të Aktivitetit të pensionisteve dhe në këtë mënyrë edhe pa-

surimin e shoqërisë.

Ndër të tjera, u diskutua që ky takim të organizohet tradicionalisht çdo vit, në të cilin do të ftohen të marrin pjesë disa shoqata pensionistësh. Pjesëtarët e kombësi-

së shqiptare u befaskan këndshëm dhe shprehën mirënjohje të madhe për të gjithë të pranishmit që bënë këtë ngjarje të mrekullueshme, të jashtëzakonshme, me dëshirën për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet. Kryetarja e Aktivitetit të pensionisteve pranë SHP Çair, Ljubica Llolevska, i përshëndeti dhe ndër të tjera theksoi se respektimi i të tjerëve, siç është me këtë rast, me fe të ndryshme dhe etni të ndryshme, por së bashku, është dëshirë e përbashkët për një shoqëri e shëndetshme ndëretnike të pensionisteve. (Vasil Paçemski)

SHP VELES

MBLEDHJA E 29-TË E MANIFESTIMIT REPUBLIKAN "ËMBËLSIRAT E GJYSHES"

Shoqata e pensionistëve Veles më 14 mars për të 29-tën herë këtë vit mbajti manifestimin "Ëmbëlsirat e gjyshes". Ngjarja u mbajt në restorantin "Kaj Zika" në Rosomanin të bukur.

Manifestimi "Ëmbëlsirat e gjyshes" u mbajt për herë të parë në vitin 1994 falë idesë së grave tona pensioniste të cilat me entuziazmin dhe angazhimin e tyre vetëmohues kontribuan për t'i dhënë kuptim ekzistencës së Aktivitetit të gruas, për të ruajtur tra-

ditën, që të mos i humbasim rrënjët. Me këtë manifestim dëshirojmë që brezave të rinj t'u përcjellim diçka që e kemi trashëguar nga gjyshet tona që të mos harrohet dhe të mbetet përgjithmonë, ashtu siç është e përjetshme Maqedonia jonë.

Në Manifestim para pensionistëve fillimisht foli dhe i përshëndeti kryetari i SHP Veles, dr. Vele Aleksoski, e më pas Manifestimin e shpalli të hapur m.r. Ilija Adamovski, kryetar i Kuvendit të

LSHPM.

Dhe këtë vit u ndje shija e "Ëmbëlsirave të gjyshes", për të cilën kontribuan shumë pensioniste punëtore nga aktivi i pensionisteve të shoqatave të vendit tonë. Kryetarja e Aktivitetit të gruas nga Veles, Bllagojka Nastova, i përshëndeti kryetarët e Aktiveve të grave dhe i falënderoi për angazhimin vetëmohues në përgatitjen e ëmbëlsirave të shijshme. Manifestimi vazhdoi me këngë e valle dhe premtim se takime të



tilla do të mbahen edhe më shpesh, në raste të ndryshme, që të mos ndalet bashkësia e anëtarëve

SHP GOSTIVAR



Punë e frytshme dhe e suksesshme

Më datë 6 mars të këtij viti, Shoqata e Pensionistëve Gostivar mbajti mbledhjen e rregullt vjetore, ku në rend dite ishin dokumentet më të rëndësishme për punën aktuale, raportin për punën e shoqatës në vitin 2023, Propozim-vendimi për miratimin e llogarisë përfundimtare për vitin 2023 dhe Propozim-vendimi për miratimin e planit financiar për vitin 2024. Pas përshëndetjes drejtuar të pranishmëve dhe të ftuarve nga shoqatat e pensionistëve nga Taftalixhe, Saraji dhe Tetova, kryetari Nijazi Xhelili në fjalën e mbajtur pas raportit, llogarisë përfundimtare dhe planit financiar, theksoi se gjatë vitit 2023 është punuar në mënyrë racionale dhe me kursim, duke marrë parasysh çdo qindarkë të shpenzuar. Në të njëjtën kohë, të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe qëllimet e përcaktuara u realizuan me sukses.

Në seksionin e Raportit Financiar për vitin 2023, janë theksuar të hyrat totale të realizuara, për dallim nga shpenzimet, që nënkupton suficitin e realizuar, mjete të cilat janë transferuar në vitin 2024. Anëtarët e Kuvendit dhe të organeve dhe trupave të tjerë, të cilët në një mënyrë të caktuar janë të përfshirë në punën e shoqatës, duhet të vazhdojnë me intensitet edhe më të madh të kryejnë detyrat që kemi para nesh, të punojnë edhe më shumë racionale dhe të gjithë së bashku të vazhdojmë për afirmimin e shoqatës sonë të pensionistëve, - theksoi në fund të seancës së Kuvendit, kryetari i SHP Gostivar, Nijazi Xhelili. (Vadije Zendeli)

të pensionistëve nga të gjitha shoqatat e LSHPM-së.

(Nada Alexoska)